



Bashkia Himarë

# Buxheti për Qytetarin 2022 - 2024

## DISCLAIMER

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Instrumentit të Planifikimit Financiar 2022 – 2024 dhe të dhënat e paraqitura në relacionin shoqërues të programit buxhetor afat – mesëm. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Himarë me asistencën e Projektit Bashki të Forta.

## Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë .....	4
Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2022 - 2024 .....	5
Burimet e financimit .....	6
Shpenzimet Buxhetore .....	8
Administrimi i Bashkisë.....	10
Rrjeti Rrugor .....	12
Shërbime Publike Vendore .....	14
Menaxhimi i mbetjeve.....	17
Projekte zhvillimi .....	19
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile .....	20
Furnizimi me ujë.....	22

## **Fjalor shpjegues**

### **Taksat e ndara**

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

### **Taksat vendore**

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

### **Tarifat vendore**

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

### **Transfertat e kushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

### **Transfertat e pakushtëzuara**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

### **Transfertat specifike**

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

### **Trashëgimi nga viti i kaluar**

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korrent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korrent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

### **Shpenzime korrente**

Këtu përfshihen të gjithë shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, që kryen bashkia për një periudhë të caktuar kohore, për përmbushjen e funksioneve të përditshme. Përmes këtyre fondeve bashkia paguan pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të bashkisë, shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, grante, transfera për familjet në nevojë dhe që përfitojnë asistencë sociale sipas përcaktimeve ligjore, etj.

# Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë

## Bashkia Himarë



Me një shtirje relativisht të gjerë gjeografike, Bashkia Himarë është një nga zonat me karakteristikat dhe të larmishme në Republikën e Shqipërisë. Kjo larmi shfaqet si në terrenin e saj dhe karakteristikat gjeografike ashtu edhe në larmishmërinë kulturore dhe demografike. Dy zonat kryesore të saj janë pjesa e ish-komunës Horë-Vranisht dhe Bashkia Himarë me njësinë administrative Lukovë. Me një fokus kryesisht në turizem dhe agro-turizëm, Bashkia Himarë pret një numër

të konsiderueshëm të turistëve të huaj dhe vendas. Sipas të dhënave të INSTAT dhe agjensive të ndryshme, zona e Rivierës Shqiptare pret numrin më të madh të turistëve të huaj kryesisht nga Polonia, Gjermania, dhe vendet skandinave. Prandaj edhe fokusi i investimeve përqëndrohet kryesisht në facilitimin e turizmit dhe në të njëjtën kohë ruajtjen e burimeve natyrore.

Objektivat kryesor të zhvillimit strategjik të bashkisë Himarë janë:

- \* Zgjerimi, mirëmbajtja dhe progresi në infrastrukturën rrugore;
- \* Investime në përmirësimin e ambienteve parashkollore, dhe parauniversitare dhe godinave publike;
- \* Mirembajtja e infrastrukturës së ujitje dhe kullimit;
- \* Shërbimet Publike vendore;
- \* Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve aq sa të reduktohen rreziqet për shëndetin publik, mjedisin, dhe tregtinë në përputhje me kërkesat e BE;
- \* Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë popullatën; Mbrojtja e të gjithë burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- \* Sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik me përqëndrim në agro-turizëm, bujqësi dhe mbështetje të ekonomisë rurale.

Qëllimi dhe objektivat kryesor të politikës së programit buxhetor të bashkisë Himarë janë:

- \* Menaxhim sa më efektiv i burimeve njërezore, rritja e aftësive funksionale;
- \* Ofrimi i shërbimeve të plota, cilësore dhe në një kohë të shkurtër për biznesin dhe qytetarët;
- \* Nxitja e qytetarëve, biznesit dhe palëve të tjera për t'u bërë pjesë e planifikimit të buxhetit;
- \* Administratë profesionale, e aftë të përballojë sfidat gjithpërfshirëse të integritimit;
- \* Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit me efikasitet të fondeve;
- \* Administrim me efikasitet dhe efektivitet i sistemit tatimor;
- \* Transparencë, informim dhe asistencë ligjore për të gjithë tatimpaguesit, etj.

## Vështrim mbi Buxhetin Afatmesëm 2022 - 2024

Bashkia ofron një buxhet realist dhe të ekuilibruar të shpërndarë mirë sipas funksioneve që ushtron. Buxheti i bashkisë ka ardhur me trend rritës, trend i cili do të vijojë edhe për vitin 2022.

Rrjeti rrugor, shërbimet publike vendore, administimi i bashkisë, menaxhimi i mbetjeve dhe projekte zhvillimi zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë për tre vitet e ardhshme. Bashkia ka rritur fokusin për përmirësimin e shërbimeve të sportit dhe turizimit duke rritur ndjeshëm financimin e këtyre shërbimeve krahasuar me vitin e kaluar.

Bashkia ka bërë një shpërndarje të mirë të fondeve të investimeve duke planifikuar investime për funksione të ndryshme të bashkisë. Bashkia do të investojë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shërbimeve publike, furnizimit me ujë, arsimit, ujitjes dhe kullimit, kulturës, sportit etj. Bashkia ka rritur fondin për investime me rreth 74% krahasuar me vitin 2021. Investimet do të zënë rreth 63% të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë.

Hartimi i projekt buxhetit kaloi përmes një procesi të gjerë konsultimi nga administrata dhe Këshilli i Bashkisë. Si rezultat i këtij procesi, ky projekt buxhet tenton t'i përgjigjet nevojave të komunitetit, duke qenë se në të janë reflektuar një pjesë e madhe e rekomandimeve të mbledhura nga procesi i konsultimit.


# Burimet e financimit

<b>FAKT 2019</b>	<b>FAKT 2020</b>	<b>PLAN 2021</b>	<b>PLAN 2022</b>	<b>PLAN 2023</b>	<b>PLAN 2024</b>
620,865	650,415	961,416	1,263,464	801,043	858,911

Kategoria	Burimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	Të ardhura nga taksat lokale	156,500	123,494	304,748	258,500	280,243	304,263
	Të ardhura nga taksat e ndara	6,000	6,000	7,000	10,400	10,658	10,975
	Të ardhura nga tarifa vendore	89,900	64,601	122,300	174,401	189,642	206,173
	Të ardhurat e tjera	27,500	17,215	39,000	39,000	40,500	42,500
<b>TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR</b>	Transferta e pakushtëzuar	115,736	118,403	135,771	124,998	193,000	205,000
	Transferta e kushtëzuar	67,000	89,754	52,114	59,264	81,000	82,000
	Trasferta specifike	48,229	49,064	3,087	0	6,000	8,000
<b>TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR</b>	Trashëgimi pa destinacion	70,000	88,074	297,396	596,901	0	0
	Trashëgimi me destinacion	40,000	93,810	0	0	0	0
<b>TË ARDHURAT TOTALE</b>		620,865	650,415	961,416	1,263,464	801,043	858,911


Viti 2019


■ TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
 ■ TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
 ■ HUAMARRJA
 ■ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



Viti 2020

■ TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
 ■ TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
 ■ HUAMARRJA
 ■ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR





### Dy fjalë mbi të ardhurat

Gjatë vitit 2022, rreth 38% e të ardhurave të përgjithshme të bashkisë do të sigurohen nga burimet e veta, ndërsa 15% e buxhetit përmes fondeve nga qeveria qendrore. Në vitin 2022 bashkia do të trashëgojë një fond të madh të papërdorur gjatë vitit 2021, i cili do të përbëjë rreth 47% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë. Ndërsa në dy vitet e tjera të planit, situata do të stabilizohet në raportin 65% nga burimet e veta me 35% nga buxheti qendror. Bashkia planifikon të sigurojë një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave nga burimet e saj, duke ulur ndjeshëm varësinë nga paratë e transferuara nga buxheti qendror.

Në tërësi për vitin 2022 bashkia planifikon:

- ✿ Të ardhurat nga burimet e veta do të rriten me 2% krahasuar me vitin 2021. Kjo rritje do të ndikohet nga rritja e të ardhurave nga tarifatat, ndërkohë që të ardhurat nga taksat vendore do të jenë më të ulta.
- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë do të rriten ndjeshëm me 31%. Rritja vjen kryesisht si pasojë e fondit të madh të papërdorur që do të trashëgohet nga viti i kaluar.


# Shpenzimet Buxhetore

<b>FAKT 2019</b>	<b>FAKT 2020</b>	<b>PLAN 2021</b>	<b>PLAN 2022</b>	<b>PLAN 2023</b>	<b>PLAN 2024</b>
620,865	650,415	961,417	1,238,539	786,644	842,595

Programi	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rrjeti rrugor rural	4,448	51,065	210,157	300,817	175,243	205,550
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	253,924	196,045	174,863	179,619	175,931	184,174
Shërbime publike vendore	258,169	126,743	149,654	251,646	126,700	130,000
Furnizimi me ujë	21,033	55,154	88,789	36,492	62,780	42,000
Menaxhimi i mbetjeve	0	70,000	75,000	140,717	78,000	79,000
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	12,508	18,000	58,780	68,799	40,100	51,000
Projekte Zhvillimi	0	0	55,409	78,746	17,000	19,000
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	37,319	27,486	36,598	34,109	16,500	18,000
Ndriçim rrugësh	0	10,000	33,000	11,791	28,000	29,021
Strehimi social	0	0	17,106	502	2,000	2,100
Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	0	8,000	13,557	21,000	9,000	10,000
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	9,589	15,589	13,307	22,563	12,000	16,000
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	12,000	5,950	11,370	8,800	7,500	8,000
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	7,188	11,091	7,907	8,224	7,240	7,400
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	602	919	7,620	7,260	20,900	31,000
Shërbimet e Policisë Vendore	0	0	5,000	12,000	2,000	2,500
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	0	49,280	1,500	1,500	1,700	1,900
Zhvillimi i turizmit	0	400	800	4,100	1,200	2,500
Mbështetje për zhvillimin ekonomik	0	500	500	500	650	700
Sport dhe argëtim	2,000	0	500	48,854	700	750
Gjendja civile	2,085	2,193	0	0	0	0
Papunësia, arsim dhe aftësim	0	0	0	500	0	0
Programet e zhvillimit	0	2,000	0	0	1,500	2,000



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Investimet</b>	235,852	196,754	446,292	776,807	435,003	480,641
<b>Shpenzimet korrente</b>	385,013	453,661	515,125	461,732	351,641	361,954



### Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 planifikohen 29% më të larta se ato të vitit 2021. Rritja e shpenzimeve reflektohet në rritjen e ndjeshme të fondeve për një pjesë të konsiderueshme të funksioneve të bashkisë. Rritjen më të rëndësishme do ta kenë këto funksione:

- \* Sport dhe argëtim;
- \* Zhvillimi i turizmit;
- \* Shërbimet e Policisë Vendore;
- \* Menaxhimi i mbetjeve;
- \* Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- \* Shërbime publike vendore;
- \* Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve;
- \* Rrjeti rrugor rural;
- \* Projekte Zhvillimi, etj

# Administrimi i Bashkisë

<b>FAKT 2019</b>	<b>FAKT 2020</b>	<b>PLAN 2021</b>	<b>PLAN 2022</b>	<b>PLAN 2023</b>	<b>PLAN 2024</b>
253,924	196,045	174,863	179,619	175,931	184,174



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Investimet</b>	55,269	68,000	61,832	74,960	68,200	68,200
<b>Shpenzimet korrente</b>	198,655	128,045	113,031	104,659	107,731	115,974

Figura 1 : Kategoritë e shpenzimeve për Administrimin e Bashkisë.

**Qëllimi i përgjithshëm:** Qeverisje vendore e përgjegjshme dhe administrata e saj transparente

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % mes punonjësve të trajnuar dhe punonjësve total	14.29	11.11	7.35	6.67	10.87	10.7	↑
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	4.4	6.11	2.45	2.22	2.17	2.14	↓

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % i numrit të vendimeve bashkiake që janë marrë pas konsultimit me publikun kundrejt numrit total të vendimeve që kërkojnë konsultim sipas ligjit	33.33	50	41.67	41.67	41.67	41.67	➡
Numri i konsultimeve me komunitetin ndaj numrit të konsultimeve të parashikuara me ligj	208.33	50	83.33	100	91.67	91.67	⬆
Buxheti i alokuar për mbështetjen e personave të papunë si asistencë sociale kundrejt numrit total të personave të mbështetur (lekë në muaj / persona të papunë)	30457.5		12951.8	16470.6	14748.2	14748.2	⬆
Numrit total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët kundrejt numrit total të mbledhjeve bashkiake (në %)	100	100	100	100	100	100	➡

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i personave të mbështetur (të papunë) me asistencë sociale	153	0	332	255	278	278
Numri i konsultimeve publike të kryera	25	6	10	12	11	11
Numri total i mbledhjeve KB të hapura për qytetarët	12	12	12	12	12	12
Numri total i mbledhjeve këshillit të bashkisë	12	12	12	12	12	12
Numri total i vendimeve të këshillit bashkiak	78	73	82	82	82	82
Vendime të këshillit bashkiak të marra pas konsultimit me komunitetin	4	6	5	5	5	5

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Punonjës të trajnuar	26	20	15	12	20	20
Ditë trajnimi në total	90	150	94	95	95	95
Masa disiplinore të marra nga stafi i bashkisë	0	12	0	0	0	0
Punonjës që janë larguar nga administrata brenda vitit	8	11	5	4	4	4
Punonjës të bashkisë në total	182	180	204	180	184	187
Punonjës që janë ulur në detyrë në administratë brenda vitit	0	0	0	0	0	0
Fondi i alokuar për asistencë sociale për personat e papunë në mijë lekë	4660	0	4300	4200	4100	4100
Numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj	12	12	12	12	12	12

Numri i instrumentave të përdorur nga bashkia: - numri i planeve sektoriale që mbulojnë vitin në shqyrtim	1	1	1	1	1	1
Numri i instrumentave të përdorur nga bashkia: - numri i planeve të detajuara që mbulojnë vitin në shqyrtim	4	7	10	10	10	10
Numri i instrumentave të përdorur nga bashkia: -plani i përgjithshëm vendor mbulon vitin në shqyrtim	1	1	1	1	1	1
Të ardhurat nga lejet e zhvillimit në lekë	205000	6119476	3000000	3090000	3183000	3183000

## INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Godina e bashkise	0	0	0	50,000	0	0

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka planifikuar shpenzime për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme për personelin, shërbime të përgjithme publike, shpenzime për ofrimin e shërbimeve që mbështesin veprimtarinë e kryetarit, këshillit dhe komisioneve të këshillit, bazat e të dhënave vendore etj.

Performanca e administratës së bashkisë do të përmirësohet falë rritjes së kapaciteteve të administratës përmes trajnimit të tyre dhe rritjes së qendrueshmërisë në punë. Në këtë mënyrë bashkia do të:

- ✿ Synojë të rrisë transparencën në procesin politikbërës duke rritur numrin e konsultimeve publike;
- ✿ Sigurojë ofrimin e shërbimeve duke zbatuar planin e përgjithshëm vendor, si dhe plane të tjera të detajuara dhe sektoriale,
- ✿ Ofrojë asistencë sociale për personat e papunë, etj.

## Rrjeti Rrugor

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
4,448	51,065	210,157	300,817	175,243	205,550



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Investimet</b>	4,000	27,500	173,271	278,150	157,243	190,910
<b>Shpenzimet korrente</b>	448	23,565	36,886	22,667	18,000	14,640

Figura 2 : Kategoritë e shpenzimeve për Rrjetin rrugor.

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % i rrjetit rrugor të mirëmbajtur ndaj rrjetit rrugor total	100	100	100	100	100	100	➡
Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km)		15	17	13	20	0	⬆
Numri i linjave interurbane të transportit publik (rritja vjetore në numër)		0	1	0	0	0	➡
Numri i automjeteve të transportit publik interurban (ndryshimi vjetor në numër)		0	0	0	0	0	➡

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rrjet rrugor i mirëmbajtur (në km)	135	150	167	180	200	200

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rrjeti rrugor në km linear në total (rural/urban)	135	150	167	180	200	200

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Gjatësia e rrjetit rrugor rural nën administrimin e bashkisë në km	115	120	135	140	150	150
Gjatësia e rrjetit rrugor urban nën administrimin e bashkisë në km	20	30	32	40	50	50
Numri i linjave interurbane të transportit publik	4	4	5	5	5	5
Numri i automjeteve të transportit publik ndërurban	13	13	13	13	13	13

## INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Rikonstruksion i rruges se varrezave Piqeras	0	0	0	3,500	0	0

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit, sinjalizimin rrugor të trotuareve dhe shesheve publike vendore si dhe realizimin e studimeve për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e bashkisë. Bashkia do të marrë masa për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural..


Performanca e këtij shërbimi do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Zgjerim të gjatësisë e rrjetit rrugor rural dhe urban nën administrimin e bashkisë;
- ✿ Mirëmbajtje të rrjetit rrugor në gjithë gjatësinë e tij, etj.

Bashkia ka rritur me rreth 43% fondet për infrastrukturën rrugore, nga të cilat rreth 61% do të përdoren për investime në rrjetin rrugor.

## Shërbime Publike Vendore

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
258,169	126,743	149,654	251,646	126,700	130,000



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Investimet</b>	130,224	24,500	37,900	133,082	40,000	42,100
<b>Shpenzimet korrente</b>	127,945	102,243	111,754	118,564	86,700	87,900

Figura 3: Kategoritë e shpenzimeve për Shërbimet Publike Vendore.

**Qëllimi i përgjithshëm:** 1. Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pamvarësisht vendndodhjes së tyre. 2. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. 3. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Km linear trotuar (ndryshimi vjetor në km linear)		1	1	2	0	0	↑
Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt popullsisë totale të bashkisë, m2/banor	1401.18	1479.24	1507.35	1542.7	1572.1	1572.1	↑
Fondi i pemëve të bashkisë, diferenca në numër kundrejt vitit të kaluar		200	580	600	650	650	↑
Numri i projekteve të reja për komunitetin, ndryshimi vjetor në numër		-9	12	0	0	0	→
Numri i projekteve rehabilituese për komunitetin, ndryshimi vjetor në numër		-1	6	2	1	0	↑

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i projekteve të reja për komunitetin	27	18	30	30	30	30
Numri i projekteve rehabilituese për komunitetin	15	14	20	22	23	23
Numri i shërbimeve të ofruara për zhvillimin e komunitetit	7	35	8	9	10	10

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Trotuarë në total (në km linear)	14	15	16	18	18	18
Numri i pemëve dekorative të mbjella në vit në hapësirat publike	550	200	580	600	650	650
Sipërfaqe e gjelbër në total (në m2)	38000000	40000000	41000000	42000000	43000000	43000000
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	27120	27041	27200	27225	27352	27352
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km2)	572	572	572	572	572	572

## INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Zgjerimi i varezave të fshatit qeparo	0	0	0	2,000	0	0
Ndërtimi i qendres së tragut të prodhimeve bujqesore	0	0	0	10,000	0	0

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike vendore, hapësirave publike dhe të gjelbërta, mirëmbajtjen e trotuarëve, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe shërbime të tjera sipas nevojave dhe specifikave të bashkisë.

Performanca e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore do të përmirësohet duke:


- ✿ Shtuar sipërfaqet e gjelbra në hapësirat publike dhe duke mirëmbajtur gjithnjë e më shumë hapësira të gjelbra;
- ✿ Mbjellë më shumë pemë dekorative në hapësirat publike, duke shtuar në këtë mënyrë fondin e pemëve dekorative të bashkisë;
- ✿ Zgjeruar gjatësinë e trotuarëve për këmbësorët
- ✿ Zhvilluar më shumë projekte rehabilituese dhe ofruar më shumë shërbime për komunitetin, etj.



Kjo falë punës së bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike dhe investimeve që do të kryhen nga bashkia në këtë shërbim.

## Menaxhimi i mbetjeve

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
0	70,000	75,000	140,717	78,000	79,000



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet korrente	0	70,000	75,000	140,717	78,000	79,000

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për Menaxhimin e mbetjeve.

**Qëllimi i përgjithshëm:** Bashkia synon përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Raporti në % i popullsisë së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj popullsisë totale të bashkisë	33.92	35.13	35.29	35.63	35.46	35.46	↑
Raporti në % i sipërfaqes së mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë	12.59	13.11	13.99	15.73	15.73	15.73	↑

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Popullata e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	9200	9500	9600	9700	9700	9700
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat rurale (ditë në javë)	4	4	4	4	4	4
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane (ditë në javë)	4	4	4	4	4	4
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në km <sup>2</sup>	72	75	80	90	90	90

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	27120	27041	27200	27225	27352	27352
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km <sup>2</sup> )	572	572	572	572	572	572

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për administrimin, mbikëqyrjen, inspektimin dhe organizimin e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve, pastrimin e rrugëve, parqeve etj.


Performanca në ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Rritje të numrit të popullsisë që përfiton nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve;
- ✿ Shtim të territorit që mbulohet nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve;
- ✿ Shërbime pastrimi dhe menaxhimi të mbetjeve me frekuencë të lartë si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, etj.

Kjo falë punës bashkisë dhe rritjes së ndjeshme të fondeve për këtë sektor të cilat do të përdoren për ofrimin e shërbimeve më cilësore për komunitetin.

## Projekte zhvillimi

FAKT 2019	FAKT 2020	PLAN 2021	PLAN 2022	PLAN 2023	PLAN 2024
0	0	55,409	78,746	17,000	19,000



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	0	0	15,000	78,746	17,000	19,000
Shpenzimet korrente	0	0	40,409	0	0	0

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për projekte zhvillimi

**Qëllimi i përgjithshëm:** Mirëmbajtja e vazhdueshme e rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimi i blloqeve të banimit dhe trotuareve



Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Projekte për komunitetin, ndryshimi vjetor në numër		6	-2	4	3	0	

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i projekteve për komunitetin	26	32	30	34	37	37

### Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për ndërtimin, mirëmbajtjen, zgjerimin, përmirësimin dhe funksionimin e strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor. Në këtë kuadër bashkia do të përmirësojë performancën e saj duke zhvilluar më shumë projekte për komunitetin, falë investimeve që do të kryhen. Fondet për investimet janë rritur ndjeshëm krahasur me vitin e kaluar

## Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
<b>Investimet</b>	0	0	0	50,000	20,000	30,000
<b>Shpenzimet korrente</b>	12,508	18,000	58,780	18,799	20,100	21,000

Figura 6 : Kategoritë e shpenzimeve për mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile.

**Qëllimi i përgjithshëm:** Bashkia synon të ulë rastet e zjarreve, përmbytjeve dhe fatkeqësive natyrore.

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë	125080	148760	419857	458660	258710	329032	↑
Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në numër)		21	19	10	5	0	↑

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda)	300	180	250	250	260	260
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin	100	121	140	150	155	155
Inspektime tek të tretët	150	78	200	250	240	240

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Numri i stacioneve MZSH	1	1	1	1	1	1
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	13	14	14	13	14	15
Total shpenzime për MZSH (në lekë)	12508000	18000000	58780000	68799000	40100000	51000000

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit



Bashkia ka planifikuar shpenzime për të siguruar funksionimin e njësisë zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimit në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Performanca në ofrimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes civile do të përmirësohet duke:

- ✿ Realizuar më shumë inspektime tek të tretët;
- ✿ Menaxhuar më shumë raste për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin, etj.

Bashkia do të rrisë fondet për këtë funksion me qëllim që shërbimi i ofruar të jetë cilësor

## Furnizimi me ujë



	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Investimet	15,933	33,754	88,789	36,492	62,780	42,000
Shpenzimet korrente	5,100	21,400	0	0	0	0

Figura 7 : Kategoritë e shpenzimeve për Furnizimin me ujë

*Qëllimi i përgjithshëm: Bashkia synon prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm në të gjithë territorin, 24 orë në ditë*

Objektivat dhe treguesit e performancës	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Trendi
Mbulimi i popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm (kundrejt popullsisë totale të bashkisë në %)	85.9	104	86.4	86.69	87.2	87.2	↑
Furnizimi me ujë - orë ujë në ditë (ndryshimi në orë)		2	4	0	0	0	→
Të ardhura nga tarifa e ujit të pijshëm kundrejt shpenzimeve totale (plus investime dhe amortizimi) për shërbimin e ujit të pijshëm në %	2.4	0.9	1.2	2.7	1.6	2.5	↑

Produkti	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm(mesatarisht orë/ditë)	18	20	24	24	24	24
Popullata që përfiton nga shërbimi me ujë të pijshëm	23295	28123	23500	23600	23850	23850

E dhëna	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Popullësia totale nën administrimin e bashkisë	27120	27041	27200	27225	27352	27352
Të ardhura nga tarifa e ujit të pijshëm (në lekë)	500000	500000	1100000	1000000	1020000	1040000
Shpenzime për shërbimin e ujit të pijshëm (në lekë)	21033000	55154000	88789000	36492000	62780000	42000000

## INVESTIMET E BASHKISË

Emërtimi i projektit	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Restaurimi i cesmes ne Vonja	0	0	0	1,000	0	0

## Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka planifikuar shpenzime për administrimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin e të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, si dhe ngritjen ose vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë.

Performanca e shërbimit të furnizimit me ujë do të përmirësohet duke:

- ✿ Rritur kohëzgjatjen e furnizimit me ujë;
- ✿ Rritur të ardhurat e mbledhura nga tarifa, duke rritur në këtë mënyrë raportin që ato zënë kundrejt shpenzimeve të bashkisë për ofrimin e këtij shërbimi;
- ✿ Ofruar shërbim për një përqindje më të lartë të popullësisë, etj.

Kjo falë investimeve që do të kryejë për rikonstrukcionin e rrjetit të ujësjellësit kryesor dhe në disa njësi administrative.